

## KAPITULLI I : Arsimi Gjithëpërfshirës

### Pyetja 1

Kush nga pohimet e mëposhtme është e gabuar për gjithëpërfshirjen:

- A) Gjithëpërfshirja ka të bëjë me vlerësimin e barabartë të të gjithë nxënësve dhe stafit të shkollës.
- B) Lidhet me përfitimin nga përvojat pozitive të tejkalimit të vështirësive,
- C) Funkcionon duke u bazuar tek masat disiplinore
- D) Pranimi i të drejtës së nxënësit për t'u arsimuar në vendin ku jeton

### Pyetja 2

Cila nga dimensionet nuk është pjesë e kornizës për gjithëpërfshirje:

- A) Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse në shkollë
- B) Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse në shkollë
- C) Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë
- D) Zhvillimi i ëorkshopeve të vazhdueshme në shkollë

### Pyetja 3

Përbërja e grupit të punës për gjithëpërfshirjen:

- A) Realizohet vetëm nga profesionsitë të jashtëm
- B) Realizohet vetëm nga mësuesit e shkollës
- C) Duhe të jetë homogjene për të siguruar qëndrueshmëri
- D) Duhet të ketë diversitet

### Pyetja 4

Parimi i diversitetit është i rëndësishëm për:

- A) Uljen e problemeve psikologjike
- B) Gjithëpërfshirjen
- C) Progresin akademik
- D) Progresin fizik

#### Pyetja 5

Krijimi i klasave të veçanta me fëmijët me zhvillim atipik:

- A) Sjell lehtësim të krijimit të marrëdhënieve
- B) Stigmatizim të tyre
- C) Optimizim të shëndetit mendor
- D) Rritje të përkujdesit

#### Pyetja 6

Mësuesja e klasës së parë është duke shpërndarë disa certifikata për fëmijët me nevoja të veçanta. Ajo është duke stimuluar:

- A) Gjithëpërfshirjen
- B) Kognicionin
- C) Vetëvlerësimin
- D) Diversietin

#### Pyetja 7

Zhvillimi i potencialit të fëmijëve me nevoja të veçanta realizohet nëpërmjet:

- A) Krijimit të një klime miqësore
- B) Ofrimit të shërbimeve mbështetëse
- C) Respektimit të dinjitetit të fëmijës
- D) Klimës miqësore, shërbimeve mbështetëse dhe respektimit të dinjitetit të fëmijës

#### Pyetja 8

Cila prej alternativave më poshtë nuk ka të bëjë me qëllimin i mbështetjes në nivelin universal:

- A) Krijimi i një atmosferë klase që përfshin të gjithë nxënësit
- B) Metodologji mësimdhënie që i përgjigjet stileve të ndryshme të të nxënësit
- C) Forma të ndryshme pune dhe mundësi të ndryshme të nxënësit për të gjithë nxënësit
- D) Modifikime të kurrikulës

### Pyetja 9

Në fokus të mbështetjes në nivel të targetuar ose selektive janë:

- A) Të gjithë nxënësit e klasës
- B) Vetëm një grup nxënësish
- C) Vetëm një nxënës
- D) Vetëm nxënësit me aftësi të kufizuar

### Pyetja 10

Ofrimi i ndërhyrjeve të targetuara specifike me qëllim parandalimin ose ndërhyrjen për nxënësit me performancë akademike apo sjellore më mbrapa nga norma e pritshme për klasën ka të bëjë me cilin prej niveleve:

- A) Ndërhyrja në nivel universal
- B) Ndërhyrja në e targetuar ose selektive
- C) Ndërhyrja në nivel intensiv
- D) Ndërhyrja në nivel individual

### Pyetja 11

Cili prej pohimeve të mëposhtme është I vërtetë për ndërhyrjen intensive:

- A) Mbështetje e individualizuar për nxënësit që nuk janë përgjigjur ashtu sic duhet ndërhyrjeve të realizuara në nivelin universal dhe në atë të targetuar.
- B) Akomodime sipas nevojave dhe pikave të forta.
- C) Adaptime të vogla të kurrikulës
- D) Mbështetje për të gjithë nxënësit e klasës

## KAPITULLI II : Personat me Paaftësi Intelektuale & Sindromë Down

### Pyetja 1

Sipas klasifikimit të çrregullimeve neurozhvillimore sipas DSM-V (APA, 2013) cila prej alternativave më poshtë nuk është nën kategoritë paaftësitë intelektuale:

- A) Paaftësitë intelektuale
- B) Vonesë zhvillimore globale
- C) Paaftësi intelektuale e paspecifikuar
- D) Çrregullime të tjera neurozhvillimore

### Pyetja 2

Cila prej alternativave më poshtë nuk është kriter që duhet të plotësohen në mënyrë që një fëmijë të diagnostikohet me paaftësi intelektuale sipas DSM-5 (APA, 2013):

- A) Deficite në funksionimin intelektual;
- B) Deficite në sjelljen përshtatëse;
- C) Deficite në motorikën grose dhe fine
- D) Deficitet ose kufizimet duhet të shfaqen gjatë periudhës së zhvillimit, pra gjatë fëmijërisë ose adoleshencës.

### Pyetja 3

Për të identifikuar personat me paaftësi intelektuale nevojitet të realizohet vlerësimi i këtyre aspekteve:

- A) Aftësi kognitive ose intelektuale
- B) Sjellja e përshtatshme
- C) Aftësitë perceptive
- D) Aftësitë intelektuale dhe sjellja përshtatëse

### Pyetja 4

Në lidhje me natyrën e paaftësisë intelektuale, Piazhe pohon se:

- A) Shkaqet gjenetike janë të vetmet shkaqe që ndikojnë tek zhvillimi i paaftësisë intelektuale
- B) Mungesa e stimuljve mjedisore shkakton vonesa në kognicion
- C) Aspekti intelektual dhe aspekti emocional janë komplementarë të veprimtarisë psikike
- D) Paaftësia intelektuale është çrregullim i inteligjencës në nivele të ndryshme

Pyetja 5

Në një shkollë fillore po zbatohet një program që nxit sjellje pozitive për të gjithë nxënësit, përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta. Kush nga parimet e mëposhtme është baza themelore për këtë praktikë edukimi?

- A) Modelimi
- B) Shuarja
- C) Përforcimi
- D) Formësimi

Pyetja 6

Në cilën prej llojeve të mëposhtme të paaftësive intelektuale, individët mund të arrijnë moshën mendore nga 0-4 vjeç?

- A) Paaftësi intelektuale e lehte
- B) Paaftësi intelektuale e moderuar
- C) Paaftësi intelektuale e thellë
- D) Paaftësi intelektuale e rëndë

Pyetja 7

Cila është fusha më e prekur tek fëmijët me paaftësi intelektuale të lehtë:

- A) Kujtesa
- B) Të menduarit
- C) Të folurit
- D) Perceptimi

Pyetja 8

Analiza e Aplikuar e Sjelljes tek fëmijët me paaftësi intelektuale ka në fokus:

- A) Mësimin e sjelljeve ndërvepruese me anë të modelimit
- B) Zëvendësimin e sjelljes jofunksionale me atë funksionale duke përdorur përforcues pozitiv
- C) Analizimin dhe heqjen e sjelljes negative duke përdorur përforcues negative
- D) Mësimin e sjelljeve të reja nëpërmjet provë-gabimit

### Pyetja 9

Fredi është nxënës në klasën e nëntë dhe po përgatitet për të kryer praktikën profesionale . Duke pasur parasysh se është diagnostikuar me paaftësi intelektuale, cila nga stategjitë do të ishte më e suksesshme gjatë praktikës së tij në një restorant:

- A) Puna në grup me nxënës të tjerë që punojnë afër tij në mënyrë që të përsërisin vazhdimisht detyrat e kërkuara
- B) Bërja e një liste me detyrat e punës në mënyrë që nxënësi t'i referohet sa herë ta ketë të nevojshme
- C) Shpjegimi i hapave të në mënyrë të kujdesshme
- D) Kryerja e praktikës vetëm në klasë duke improvizuar një mjedis pune

### Pyetja 10

Mësuesja ka planifikuar t'iu lexojë nxënësve me paaftësi intelektuale të lehtë një tregim për balenat. Paraprakisht, mësuesja pyet se çfarë dinë ata për balenat dhe përgjigjet e tyre i shkruan në dërrasë. Ky aktivitet lehtëson të kuptuarin e historisë që do të lexohet sepse:

- A) I nxit studentët që të mësojnë më shumë rreth temës
- B) I inkurajon studentët që të përdorin stategjitë metakognitive
- C) Integron të shkruarit dhe gjuhën verbale
- D) Lidh informacionin e ri me njohuritë e mëparshme

### Pyetja 11

Nëna e D. është e shqetësuar rreth zhvillimit të djalit të saj. Vlerësimet e kryera treguan se ai kishte koeficient inteligjence të ulët dhe probleme me komunikimin, që janë treguese të paaftësisë intelektuale. Cila nga shkaqet e mëposhtme nuk mund të lidhet me paaftësinë intelektuale të D-së?

- A) Infeksionet e nënës gjatë shtatëzanisë
- B) Prania e një të afërmi me paaftësi intelektuale
- C) Niveli i ulët arsimor i nënës
- D) Trauma gjatë lindjes

### Pyetja 12

Problemet me dinamizmin intelektual tek fëmijët me paaftësi intelektuale shprehn tek:

- A) Zhvillimi motorik
- B) Aftësia për të perceptuar stimuj
- C) Aftësia për të kuptuar emocionet

D) Aftësia për të abstraguar

Pyetja 13

Teknika më efektive për zhvillimin e lingustikës me nxënësit e klasës së dytë me paaftesi intelektuale është:

- A) Nxitja e diskutimit në klasë
- B) Prezantimi i fjalorit të nevojshëm në kontekstin e të mësuarit
- C) Përdorimi i teksteve të shkruara
- D) Përdorimi i vizatimit për fjalët e vështira

Pyetja 14

Mësuesi I arsimit special është duke ndërtuar planin e punës për lëndën e matematikës për një grup të vogël të fëmijëve me paaftësi të lehtë intelektuale dhe vështirësi në të nxënë. Cila do të ishte teknika më e përshtatshme që duhet të ndjekë ai:

- A) Të fokusohet tek konceptet që përdoren gjerësisht në përditshmëri
- B) Të theksojë rëndësinë e përdorimit të matematikës në shkencë dhe teknologji
- C) Të nxisë arsyetimin deduktiv
- D) Të lidhë konceptet matematikore me shembuj konkretë të njohur nga nxënësit

Pyetja 15

Fëmijët e avashtë në të nxënë kanë Koeficient Inteligjence

- A) 70-75
- B) 25-30
- C) 75-90
- D) 35-50

Pyetja 16

Funksionimi intelektual ka të bëjë me:

- A) Kapacitetin për të folur qartë
- B) Kapacitetin për të njohur dhe ndjerë emocione
- C) Kapacitetin për të mësuar dhe arsyetuar
- D) Kapacitetin për të krijuar marrëdhënie sociale

Pyetja 17

Sipas DSM V, paaftësia intelektuale është një:

- A) Crregull komunikimi
- B) Crregullim neurozhvillimor
- C) Crregullim afektiv
- D) Crregullim personaliteti

Pyetja 18

Risia në procesin e vlerësimit të paaftësive intelektuale lidhet me:

- A) Vlerësimin e koeficientit të inteligjencës
- B) Ndryshimin në terminologji
- C) Vlerësimin e aftësisë për t'u përshtatur
- D) Nuk ka risi në vlerësimin e paaftësisë intelektuale

Pyetja 19

Cili term përdoret për të përshkruar faktorët që luajnë një rol në shkaktimin e një sëmundjeje?

- A) Prevalencë
- B) Eziliencë
- C) Etiologji
- D) Klasifikim

Pyetja 20

Kush nga faktorët e mëposhtëm shkakton Sindromën Down?

- A) Anormaliteti kromozomik
- B) Ekspozimi prenatal ndaj alkoolit
- C) Deprivimi nga oksigjeni gjatë lindjes
- D) Defektet neural

Pyetja 21

Cili tip i Sindromës Down ndodh kur një pjesë e kromozonit 21 është e lokalizuar në një kromozon tjetër?

- A) Mozaik
- B) Trisomia 21
- C) Random
- D) Translokim



#### Pyetja 22

Kush nga pyetjet e mëposhtme nuk është e vërtetë për fëmijët me Sindromën Down:

- A) Individët me sindromën Down nuk janë aspak social
- B) Moshë e nënës, mosha e babait dhe lindja e mëparshme e një fëmije me Sindromën Down konsiderohen si faktorë rrisht.
- C) Fëmijët me Sindromën Down kanë problem në paraqitjen fizike.
- D) Triple test dhe hamony test përdoren për diganistikimin prenatal të fetusit

#### Pyetja 23

Strategjia që përdoret për të nxitur zhvillimin e gjuhës tek fëmijët me Sindromën Down është:

- A) Përdorimi i pyetjeve të mbyllura.
- B) Përdorimi i shenjave për të lehtësuar zhvillimin e gjuhës.
- C) Të mësuarit e gjuhës vetëm me anë të dëgjimit
- D) Praktikimi i gjuhës në situata familjare dhe të huaja.

#### Pyetja 24

Aminocenteza është:

- A) Problem kognitiv
- B) Metodë e përdorur për të vlerësuar shkallën e kufizimeve tek fëmija
- C) Metodë e përdorur për të testuar prezencën e Sindromës Down
- D) Problem shëndetësor

#### Pyetja 25

Gjatë orës së mësimit me fëmijët me Sindromën Down, është e rëndësishme që mësuesit të evitojnë:

- A) Prezantimet vizuale
- B) Dhënien e instruksioneve njësoj si për gjithë klasën
- C) Lavdërimet dhe inkurajimet
- D) Punën në grupe

### Pyetja 26

Motivimi është shumë i rëndësishëm për fëmijët me Sindromën Down . Një nga strategjitë më të suksesshme për rritjen e motivimit është:

- A) Puna në grupe me nxënësit e tjerë
- B) Dhënia e rolit të liderit
- C) Dhënia e detyrave me koncepte familjare dhe të njohura në mënyrë që fëmija të përjetoj suksese të vogla
- D) Mentorimi nga një nxënës tjetër

### Pyetja 27

Fëmijët me sindromën Down mund të shfaqin sjellje agresive dhe të papërshtashme në situata të ndryshme. Më poshtë identifikoni pohimin e gabuar:

- A) Fëmijët me sindromën Down mund të shfaqin sjellje agresive pasi iu pëlqen të jenë në qendër të vëmendjes.
- B) Fëmijët me sindromën Down mund të shfaqin sjellje agresive sepse ndjehen të frustruar dhe në ankth.
- C) Fëmijët me sindromën Down mund të shfaqin sjellje agresive sepse nuk iu pëlqen e njëjta rutinë.
- D) Fëmijët me sindromën Down mund të shfaqin sjellje agresive sepse imitojnë bashkëmoshtrët e tyre.

### Pyetja 28

Strategjia më e mirë për të eliminuar sjelljet e papërshtatshme në terma aftagjatë tek fëmijët me Sindromën Down është:

- A) Injorimi i sjelljeve të papërshtatshme
- B) Mësimi i sjelljeve alternative të përshtatshme
- C) Nxitja e imitimit të sjelljeve të bashkëmoshatarëve
- D) Nxitja e imitimit të sjelljes së mësuesve

### Pyetja 29

Shumë fëmijë me Sindromën Down janë nxënës pasivë sepse:

- A) Kanë probleme me aftësitë sociale
- B) Kanë pak aftësi për të mësuar
- C) Janë shumë të ndjeshëm ndaj dështimit
- D) Nuk iu pëlqen pjesëmarrja aktive

Pyetja 30

Si strategji për të promovur gjuhën tek fëmijët me Sindromën Down, është e nevojshme:

- A) Përcaktimi i limiteve kohore për tu përgjigjur
- B) Drejtimi i pyetjeve të hapura
- C) Dhënien e një alternative të vetme përgjigje
- D) Drejtimi i pyetjeve të mbyllura

Pyetja 31

Për të menaxhuar inatin dhe frustacionin tek fëmijët me Sindromën Down, është e nevojshme:

- A) Injorimi i kësaj sjellje
- B) Dhënia e detyrave të përshtatshme me moshën
- C) Diskutimi në moment i sjelljes
- D) Ndëshkimi për sjelljen e shfaqur

Pyetja 32

Përsa i përket aspektit mësimor, fëmijët me Sindromën Down:

- A) Kanë kujtesë të mirë afatgjatë
- B) Kanë kujtesë të mirë afatshkurtër
- C) Kanë aftësi të mira në lexim
- D) Kanë probleme me kujtesën vizuale

Pyetja 33

Fëmijët me Sindromën Down shfaqin probleme me:

- A) Kujtesën vizuale
- B) Zhvillimin e amygdalës
- C) Vëllimin e korteksit
- D) Kujtesën auditive

Pyetja 34

Lehtësia për të mësuar të gjithë fjalën dhe jo shkronjat veçmas është tregues i:

- A) Vështirësisë për tu përshtatur qasjes së mësimdhënies në shkollë
- B) Stilin auditiv të të mësuarit
- C) Stilin vizual të të nxënit
- D) Impaktin e mjedisit tek të nxënit

Pyetja 35

Qëllimi kryesor i ndërhyrjeve tek fëmijët me Sindromën Down duhet të jetë:

- A) Menaxhimi i zemërimit
- B) Mbrojtja ndaj veprimeve vetëdëmtuese
- C) Progresi akademik
- D) Zhvillimi i autonomies

Pyetja 36

Stimulimi i proceseve të të mësuarit tek individët me Sindromën Down:

- A) Duhet të ndodhë përgjatë gjithë jetës
- B) Duhet të zhvillohet intensivisht gjatë fëmijërisë së hershme
- C) Duhet të realizohet përmes imitimit
- D) Duhet të ndodhë përgjatë adoleshencës

Pyetja 37

Fëmijët me Sindromën Down diagnostikohen lehtësisht:

- A) Për shkak të problemeve të theksuara me kognicionin
- B) Për shkak të karakteristikave fizike
- C) Për shkak të sjelljeve agresive
- D) Për shkak të probleme në marrëdhënie me të tjerët

Pyetja 38

Gjatë punës me fëmijët me Sindromën Down:

- A) Duhet përdorur material me kuptim për ta
- B) Duhet përdorur fjalë ambige
- C) Duhet komunikuar në mënyrë pasive
- D) Duhet të përdoren fjalë me kuptime të ndryshme

### Kapitulli III. Çrregullimet e Spektrit të Autizmit

#### Pyetja 1

Cila nga alternativat nuk është përcaktuese për diagnostifikimin e autizmit:

- A) Dëmtim i ndërveprimit social
- B) Dëmtim i komunikimit
- C) Modele të sjelljes përsëritëse
- D) Vonesë mendore

#### Pyetja 2

Cila nga alternativat është përcaktuese për klasifikimin e autizmit:

- A) Dëmtim i sjelljeve verbale
- B) Hiperaktivitet
- C) Pasiviteti
- D) Sjelljet steriotipe

#### Pyetja 3

Cila nga shenjat në moshën e hershme nuk është tregues për autizmin:

- A) Çrregullime të gjumit
- B) Shfaqja e ankthit
- C) Mosinteres ndaj lojrave
- D) Humbje e aftësive të fituara

#### Pyetja 4

Cili sindrom i çrregullimit të autizmit nuk paraqet klinikisht një vonesë mendore?

- A) Rett
- B) Kaner

C) Asperger

D) Crregullimi disintegrativ i fëmijërisë

Pyetja 5

Stereotipia te personat me crregullime të spektrit të autizmit nuk:

A) I përgjigjet stilit kognitiv

B) Lejon komunikim me ambientin rrethues

C) I përgjigjet nevojave të personit

D) Sjell irritim

Pyetja 6

Karakteristikë e sindromës Asperger është:

A) Ekziston një vonesë e përgjithshme e të folurit

B) Ka vonesa në zhvillimin kognitiv

C) Ka hiperaktivitet

D) Ka karakter përsëritës të sjelljeve (stereotipi)

Pyetja 7

Sindroma e Rett-it ndodh:

A) Te djemtë

B) Te vajzat

C) Te të dy gjinitë

D) Asnjëherë

#### Pyetja 8

Crregullimet e rënda motorike ndodhin te personat me crregullime të spektrit të autizmit të:

- A) Asperger
- B) Rett
- C) Kaner
- D) Asnjë

#### Pyetja 9

Mutizmi (mungesa e të folurit) te fëmijët me autizëm është kur:

- A) Flet pa kuptim
- B) Mëson fjalë të reja dhe humbet të vjetrat
- C) Nuk flet asnjëherë
- D) Flet pak fjalë

#### Pyetja 10

Ekolalia te një person me crregullime të spektrit të autizmit është:

- A) Të folurit instrumental
- B) Mospërdorimi i përemrave vetor
- C) Paaftësi për të përgjithësuar gjuhën
- D) Imitimi i gjuhës në mënyrë passive

#### Pyetja 11

Metoda terapeutike që NUK përdoret për fëmijët me spektrin e autizmit është:

- A) ABBA
- B) Chelaton
- C) Hap pas hapi
- D) TEACCH

### Pyetja 12

Strategjitë e përdorura në klasë për nxënësit me autizëm duhet të jenë:

- A) Të ndryshueshme
- B) Me suporte auditive
- C) Rutinë
- D) Asnjë

### Pyetja 13

Ani është 19 vjec dhe ka crregullim të spektrit të autizmit. Ai merr pjesë në modelin e funksionimit të arsimit special të;

- A) Klase speciale
- B) Integrim i pjesshëm
- C) Integrim i plotë
- D) Integrim profesional

### Pyetja 14

Cila nga shkaqet e mëposhtme nuk është përcaktues për crregullimin e spektrit të autizmit:

- A) Shkaqe gjenetike
- B) Shkaqe biokimike
- C) Mungesa e atashimit
- D) Shkaqe neuroanatomike

### Pyetja 15

Izolimi social i fëmijëve me autizëm, nuk lidhet me:

- A) Mungesën e vëmendjes



- B) Mungesën e shkëmbimit emocional
- C) Mungesën e empatisë
- D) Mungesën e lojës bashkëpunuese

Pyetja 16

Cili nga llojet e komunikimit është më efektiv për të mësuarin e nxënësit me autizëm?

- A) Komunikimi verbal
- B) Komunikimi me tabela
- C) Komunikimi joverbal
- D) Komunikimi pasiv

Pyetja 17

Organizimi efektiv i klasës në funksion të të nxënësit me autizëm, nuk lidhet me:

- A) Përcaktimin e këndeve të specializuara
- B) Afishimin e tabelave të komunikimit
- C) Afishimin e larmishëm të fotove me ngjyra
- D) Pozicionimin e nxënësit në bangat e para

Pyetja 18

Për përmirësimin e një sjelljeje jo të përshtatshme, mësuesi duhet të përdorë:

- A) Shpërblime
- B) Teknikën e selektimit të vëmendjes
- C) Ndëshkime fizike
- D) Shpjegime verbale

## Kapitulli IV Problemet e shikimit, edukimi dhe mësimdhënia

### Pyetja 1

Sipas teorisë së ngjashmërisë imazhi është:

- A) Një objekt i transformuar
- B) Një shenjë e natyrshme e asaj çka përfaqëson
- C) Një mesazh që transmetohet
- D) Një shenjë që njih, kupton dhe vlerëson

### Pyetja 2

Imazhi mendor te fëmijët me shikim të dobët:

- A) Ka lidhje direkte me eksperiencën personale
- B) Është stabël por më pak i pasur
- C) Nuk ndryshon nga një individ te tjetri
- D) I referohet një mesazhi që transmetohet

### Pyetja 3

Symptomat e mëposhtme bëjnë pjesë në anomalitë e syrit, përveç:

- A) Presion i lartë brenda syrit
- B) Bllokim i lëngjeve që qarkullojnë normalisht brenda syrit
- C) Lënda e syrit është opake, jo e tejdukshme
- D) Dëmtim i nervit optik nga rritja e presionit

### Pyetja 4

Problemet e mëposhtme kanë të bëjnë me gabimet refraktare, përveç:

- A) Strabizmi
- B) Hipermetropia
- C) Miopia
- D) Astigmatizmi

### Pyetja 5

Ulja ose mungesa e melaminës tek albinët mund të çojë në:

- A) Fotofobi dhe ulje të mprehtësisë së pamjes
- B) Retinopati pigmentare
- C) Strabizëm
- D) Hipermetropi

Pyetja 6

Nëse fëmija ka verbëri të ngjyrave, mësuesi duhet:

- A) Të printojë në letër të kuqe ose jeshile
- B) Të mos etiketojë mjetet me ngjyra (si lapsa, kolora etj) me emrin e ngjyrës
- C) Të përdorë dërrasë me ngjyra dhe jo me letër të bardhë
- D) Në figurat që kërkojnë njohje të ngjyrave, të vendosë etiketa me fjalë ose simbole

Pyetja 7

Të shohësh do të thotë:

- A) Të përqëndrohesh në të mësuarin fizik po jo atë konjitiv
- B) Të jesh i aftë të interpretosh sensacionet vizuale të marra
- C) Të mos reagosh në mjediset ku funksionon
- D) Të jetosh eksperiencia vizuale, por jo në funksion të kapaciteteve të personit

Pyetja 8

Kur flasim për vision funksional mund të themi që:

- A) Truri nuk zgjedh
- B) Truri nuk identifikon
- C) Syri është i impresionuar
- D) Sistemi nervor nuk transmeton

Pyetja 9

Aftësia për të përfshirë objektet në shkëmbimet sociale tek fëmijët që nuk shikojnë:

- A) Zhvillohet me shumë vonesë
- B) Zhvillohet në të njëjtën kohë me fëmijët që shikojnë
- C) Nuk ndikon në komunikim
- D) Nuk ndikon në ndërveprimin me të tjerët

Pyetja 10

Te fëmijët e verbër vonesa në zhvillimin e fjalëve të para:

- A) Nuk ndikon në formimin gjuhësor të mëvonshëm
- B) Mund të vijë nga fakti se gjestet në mbështetje të përvetësimit të gjuhës nuk perceptohen
- C) Nuk e ka të rëndësishme korelacionin taktil midis fjalës dhe objektit
- D) I jep më shumë rëndësi stimujve të mjedisit por jo zhvillimit të shprehjeve të fytyrës si pjesë e mësimit të gjuhës dhe komunikimit

Pyetja 11

Zhvillimi motor është ndikuar nga verbëria në mënyrë direkte si pasojë e:

- A) Kufizimit të aktivitetit motorik në mungesë të një stimuli vizual
- B) Stimulim të mjaftuesësh fillestar social
- C) Më shumë siguri në sjellje eksploruese
- D) Aftësisë për të marrë sigurinë emocionale nga nëna nëpërmjet kontaktit të thjeshtë me sy

Pyetja 12

Problemet në zhvillimin konjitiv të fëmijës së verbër vijnë nga:

- A) Lëvizja e pakushtëzuar drejt njerzëve dhe objekteve që u ngjallin interes
- B) Eksplorimi i lirshëm individual
- C) Motivimi nxitës që vjen nga shikimi
- D) Mospënimimi i imitimit gjatë ndërveprimit

Pyetja 13

Në specifikat e të nxënies të fëmijët me probleme në shikim mund të themi që:

- A) Shikimi i zvogëluar ose mungues nuk e ndikon zhvillimin e personit
- B) Në momentin e shkollës fëmija që nuk sheh ka të njëjtin bagazh me fëmijën që sheh
- C) Në procesin interaktiv të zhvillimit veprojnë faktorët fizikë dhe psikikë por jo ata mjedisorë
- D) Një ndryshim në potencialin e shikimit sjell një ndryshim në zhvillim

Pyetja 14

Fëmijët që nuk shikojnë:

- A) Kanë eksperiencë personale të botës më pak të gjerë
- B) Përfytyrime mendore të pasura
- C) Janë autonom në organizim dhe zhvendosje
- D) Tendencë për përfshirje në aktivitete sociale

Pyetja 15

Alfabeti Brajl:

- A) Është alfabet si për personat që nuk shikojnë ashtu edhe për personat që nuk dëgjojnë
- B) Sot është një alfabet unik dhe i pasuruar me shenjat përkatëse kombëtare
- C) Nuk ka ndryshuar me kalimin e viteve
- D) Nuk është unifikuar në gjuhën shqipe

Pyetja 16

Te fëmijët që nuk shikojnë, të ushtruarit për perceptimin e objekteve është pjesë e:

- A) Llogaritjeve për kombiminin e pikave të alfabetit Brajl
- B) Shpejtësisë të të lexuarit me Brajl
- C) Strategjive të të lexuarit me Brajl
- D) Fazave fillestare të shkrimit me Brajl

Pyetja 17

Mobiliteti:

- A) Nuk realizon ushtrime me të dëgjuarin
- B) Nuk realizon ushtrime me të nuhaturin
- C) Nuk realizon ushtrime me të prekurin
- D) Tenton të mësojë dhe stërvisë nxënësit e verbër të orientohen në hapsirë

Pyetja 18

Me mobilitet të personave të verbër kuptojmë:

- A) Dhënien e një sigurie më të madhe në hapsirën që i rrethon, shtëpi, punë, komunitet duke i bërë më të pavarur
- B) Që procesi kryhet nga një mësues i specializuar, pa ndihmën e profesionistëve të tjerë, si fizioterapistët për shembull
- C) Se është një proces i kufizuar vetëm në ambjentin familjar të personit
- D) Se efikasiteti i procesit nuk varet nga bashkëpunimi i profesionistëve ndihmues

Pyetja 19

Gjatë trajtimit pedagogjik të personave me dëmtime në të parë metoda mësimore hap pas hapi:

- A) Vendos mësuesi në epiqendër
- B) Motivon fëmijën që të njohë objektet që e rrethojnë
- C) Nënkupton që së pari i duhet dhënë rëndësi ambjentit ku fëmija funksionon (jeton dhe mëson)
- D) U shpjegon fëmijëve proceset e jetës së përditshme

Pyetja 20

Metoda e ushtrimeve:

- A) Aktivizon nxënësin me paaftësi në të parë që mësimin e marrë ta përvetësojë nëpërmjet punës praktike
- B) I shpjegon nxënësit duke ju përgjigjur pyetjeve
- C) Mbështet teorinë që fëmijës duhet t'i mbushet mendja siç mbushet një enë me ujë
- D) Nxit kureshtjen e fëmijës nëpërmjet bashkëbisedimit

## Kapitulli V : Probleme të dëgjimit. Shurdhëria

### Pyetja 1

Daullja e veshit është pjesë e:

- A) Veshit të jashtëm
- B) Veshit të mesëm
- C) Veshit të brendshëm
- D) Llapës së veshit

### Pyetja 2

Otitis media është sëmundje që prek:

- A) Veshin e jashtëm
- B) Veshin e mesëm
- C) Veshin e brendshëm
- D) Kanalin e veshit

### Pyetja 3

Kur ndodh shurdhimi perceptiv është dëmtuar:

- A) Kërmilli
- B) Yzengjia
- C) Veshi i brendshëm
- D) Veshi i jashtëm

### Pyetja 4

Kur flasim për fëmijë pjesërisht të shurdhër kemi parasysh që:

- A) Dëgjojnë mirë
- B) Dëgjojnë pak dhe mundet dalëngadalë të mësojnë të përgjigjen
- C) Nuk dëgjojnë fare
- D) E kanë shumë të vështirë komunikimin

### Pyetja 5

Pasi vendosin implantin kokleat, fëmijët bëhen të vetëdijshëm ndaj tingujve që dëgjojnë. Ky proces quhet:

- A) Përvetësim gjuhësor
- B) Zhvillimi i qëndrimit ndaj dëgjimit
- C) Belbëzim
- D) Përvojë në të folur

Pyetja 6

Faza e parë e përvetësimit të gjuhës së shenjave është faza e:

- A) Fjalive me dy fjalë
- B) Gugatjeve
- C) Belbëzimit të rrokjeve
- D) Fjalive me më shumë se dy fjalë

Pyetja 7

Në shekullin e XVII shkollimi ose të paktën aftësimi për shkrim dhe lexim i personave me probleme në dëgjim e bënte:

- A) Kisha nëpërmjet klerikëve
- B) Institucionet shtetërore
- C) Shkollat
- D) Komuniteti

Pyetja 8

Shkollat e para për mësimin e personave me problem në dëgjim u hapën në:

- A) Azi
- B) Amerikë
- C) Europë
- D) Angli

Pyetja 9

Gjatë terapisë së të folurit e rëndësishme është që:

- A) Të flasim me zë të lartë
- B) Të kthejmë fytyrën nga fëmija dhe të jemi të sigurt që na shikon
- C) Drita të jetë vetëm në një pjesë të dhomës
- D) Ta mos përdorim shkrimin

Pyetja 10

Humbja kogjenitale e dëgjimit:

- A) Pësohet vetëm nga sëmundjet infektive
- B) Është e fituar
- C) Nuk identifikohet me testet e dëgjimit të fëmijët
- D) Është e pranishme që në lindje

Pyetja 11

Gjatë zhvillimit të hershëm të shkrim-leximit, ekspozimi i përshtatshëm në sasi dhe cilësi ka lidhje me:

- A) Zhvillimin e gjuhës për komunikimin sy me sy
- B) Përdorimin e gjuhës për të komunikuar me të tjerët
- C) Shprehja verbalisht e vetes
- D) Një imput gjuhësor i arritshëm

Pyetja 12

Leximi dhe shkrimi zhvillohen kur:

- A) Fëmija vihet në kontakt me botën e jashtme
- B) Fëmijët janë prezantuar me gjuhën e shkruar
- C) Fëmija fillon të vizatojë
- D) Fëmijët mësojnë të zhgarravisin

Pyetja 13

Niveli i parë gjatë mësimin të gjuhës së shkruar të fëmijët me problem në dëgjim është:

- A) Dallimi i shkrimit nga vizatimi
- B) Identifikimi i shenjave karakteristike të shkrimit
- C) Lidhja e shkrimit me gjuhën e folur
- D) Shkrimi interaktiv

Pyetja 14

Gjatë shkrimit interaktiv:

- A) Vetëm nxënësit marrin një rol aktiv në procesin e shkrimit
- B) Mësuesi nuk ndërhyr dhe nuk mbështet gjatë procesit të shkrimit
- C) Nxënësit lënë çdo gjë në dorë të mësuesit
- D) Mësuesi dhe nxënësi punojnë sëbashku për të shkruar një tekst

Pyetja 15

Problemet psikologjike që shfaqen më shpesh te fëmijët me probleme në dëgjim janë:

- A) Anoreksi
- B) Çrregullime të sjelljes
- C) Obsesion-Kompulsion
- D) Disocim

Pyetja 16

Çrregullimet e gjumit te fëmijët me probleme në dëgjim vijnë si pasojë e:

- A) Faktit që mungesa e dëgjimit imponon mungesën e një hapsire kalimtare sonore ndërmjet dhomës së fëmijëve dhe dhomës së prindërve duke shkaktuar frikë
- B) Pajisjes pas diagnostikimit me mjete ndihmëse dëgjimi që ndikojnë dhe te marrëdhënia me të tjerët
- C) Praktikat e gjuhës së shenjave që janë të lodhshme dhe sfiduese
- D) Refuzimi që kanë për gjendjen dhe dhimbja që u shkakton situata

Pyetja 17

Fëmija shurdh:

- A) Nuk arrin të komunikojë dot në asnjë moment me prindërit e tij
- B) Edhe pse mund të punohet nuk arrin dot të zhvillohet konjitivisht
- C) Ka si synim të komunikojë në mënyrë të pjesshme me botën që e rrethon
- D) Ka si qëllim kryesor të përshtatet me dy botët (botë e atyre që dëgjojnë dhe atyre që nuk dëgjojnë)



Pyetja 18

Te fëmijët me humbje të fortë të dëgjimit:

- A) Gjuha e shenjave duhet të jetë një nga gjuhët e para që mësojnë pasi vjen më natyrshëm
- B) Përshtatja e mjedisit nuk ka rëndësi më të mësuar
- C) Ndërhyrja e hershme bën një diferencë minimale në edukim
- D) Mësimi i dygjuhëve (gjuha e shenjave dhe gjuha e folur) nuk është vlerë e shtuar

Pyetja 19

Për të parandaluar problemet në dëgjim:

- A) Nuk ka rëndësi ushqyerja para dhe gjatë shtatëzarisë
- B) Vaksinimi i vajzave dhe grave kundër rubeolës nuk bën diferencë në shëndetin e fetusit
